Kronikë

Durrës/ Pas sherrit i shkon te shtëpia dhe e kanos me të shtëna çifteje në ajër, arratiset pas krimit! I dyshuari kthehej i dehur nga një dasmë (Emrat)

Ngjarja mesnatën e djeshme në Shkallnur, agresori xhiroi gomat e makinës dhe debatoi me banorët. Policia e shpall në kërkim. Arma e gjahut me leje, në pronësi të babait të autorit

Foto arkiv

Redaksia
16 Gusht, 10:41 | **Përditesimi: 16 Gusht, 12:14**

Share

Durrës- Sherri mes dy personave në Durrës ka përfunduar me të shtëna arme gjahu dhe kanosje nga i pari, tek banesa e personit tjetër me të cilin u konfliktua.

Policia vendore e Durrësit konfirmoi ngjarjen e ndodhur mesnatën e mbrëmshme (15 Gusht), në fshatin Shkallnur dhe se konflikti ka për motive nga hetimet paraprake, ato të dobëta.

Burime zyrtare sqaruan se rreth orës 23:50, shtetasi i identifikuar si Edison Gjuzi, 32 vjeç, akuzohet se ka qëlluar me armë gjahu në ajër, në afërsi të banesës së bashkëfshatarit Rifat T., me qëllim kanosjen. Pas krimit i dyshuari është arratisur nga vendngjarja dhe u shpall në kërkim.

LEXO EDHE:

'Të kam taksur një dhuratë! S'e dija që zarfi kishte para' Dëshmia në GJKKO e shefit të Antidrogës së Durrësit! Gazmir Preçi akuzohet se shantazhoi pronarin e klubit, i mori 10 mijë euro

Nga dëshmitë e mbledhura deri tani nga policia, rezulton se agresori ka qenë në një dasmë dhe në gjendje të dehur ka nisur të xhirojë gomat e makinës dhe prishë qetësinë publike në fshat. Banorët e kanë kështilluar dhe në debat është përfshirë edhe personi i kanosur. Kaq ka mjaftuar që i dyshuari të shkojë në banesë dhe të marrë armën e zjarrit.

> *"Shërbimet e Policisë ndodhen në vendngjarje dhe po bëjnë krehjen e zonës, me qëllim kapjen e autorit", thuhet në njoftimin zyrtar.*

Në cilësinë e provës materiale është sekuestruar arma e gjahut me të cilën qëlloi agresori, e cila posedohej me leje nga babai i tij. Ndërkaq, një grup i posaçëm hetimor po punon për të zbardhur rrethanat e rastit, shkakun, dinamikën dhe hollësi të tjera me interes për rastin.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: arme gjahu | kanosje | Durres

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Ftesa e Ramës, a duhet të kthehen emigrantët që punojnë në turizëm?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Protestë në aksin Thumanë- Kashar, banorët kërkojnë hyrje dhe dalje për pronat e tyre! Policia ndërhyn për t'i larguar nga rruga! Hidhet gaz lotsjellës
16 Gusht, 20:03

U hetua se lejoi kultivimin e kanabisit në Mallakastër, Gazmir Preçi 3 vite më pas Shef Antidroge në Durrës! Arrestohet për gjobëvënie! Ministri: Policët 'padronë' ndëshkohen
16 Gusht, 11:57

Pantoflat e Shefit të Antidrogës në Durrës... dhe karriera e tij misterioze pas kanabisit në Mallakastër
Alba Malltezi
16 Gusht, 11:34



Shefi i Antidrogës së Durrësit gjobëvënie biznesmenëve, në pranga me urdhër të SPAK! Shantazhoi pronarin se do i mbyllë lokalin, i mori 10 mijë euro
15 Gusht, 21:30

Shijak/ Ndezi zjarr për mbeturinat, flakët dolën jashtë kontrollit duke djegur një sipërfaqe me të mbjella! Hetim në gjendje të lirë për 83 vjeçarin
15 Gusht, 15:41

Vodhi në dy lagje të Durrësit një makinë dhe çantën e një turisti, kapet në Elbasan 29 vjeçari! Ishte në kërkim dhe nga policia e Tiranës për 4 vjedhje (EMRI)
15 Gusht, 15:22

I njohur si 'Zoti i drogës', konfiskohen pasuritë e Alket Hatijës dhe familjarëve të tij! I dënuar në Itali për trafik narkotikësh me vlerë 40 mln euro
15 Gusht, 10:18

Fluks pasagjerësh në portet e Durrësit dhe të Vlorës! Për 10 ditë u regjistruan mbi 100 mijë pasagjerë
14 Gusht, 17:43

'Përdorim forcën për këdo që e bllokon' Rrumbullaku paralajmëron protestuesit: Autostrada Thumanë - Kashar e kategorisë A1
14 Gusht, 14:36

Ministrja Koçiu inspekton vijën bregdetare të Golemit për kushtet higjieno-sanitare: Nga 1 qershori deri më 9 gusht, 2,961 kontrolle
13 Gusht, 16:10

E rëndë në Durrës, 47 vjeçari bie aksidentalisht nga ballkoni dhe humb jetën
12 Gusht, 23:02

'Turistë të përgjuar': Pushime nën syrin vigjilent të Sigurimit
Gëzim Kabashi
12 Gusht, 18:04

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje